

Dalës-izlaza

Nr. -1-23
 Br.

Data 22.02.2021
 Datum

OBILIQ - OBILIĆ



Republika e Kosovës- Republika Kosovo- Republic of Kosova

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opština Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Datë/Data/Date	22.02.2021
Nga/Od/From:	Kryesuesi i Kuvendit Komunal –z.Burim Gërguri Grupi punës për hartimin e planit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2021 1.Lulzim Sadiku (PDK) 2.Fatos Kurshumlia (LDK) 3.Nazmi Gashi (Nisma) 4. Slavisha Spasic (SL) 5. Valmir Sadiku –Shoqeria Civile - IZHL
Për/Za/To:	Kuvendin Komunal –Obiliq
Tema/Subjekat/Subject:	Draft plani i punës së Kuvendit Komunal dhe aktiviteteve

Të nderuar koleg !

Bazuar në vendimin e datës I-357 të datë 30 Dhjetor 2020 , Kryesuesi i Kuvendit dhe grupi punues për hartimin e punës së Kuvendit Komunal për vitin 2021 .

Komiteti për Politike dhe Financa e ka punuar në planin e punës

Kuvendi Komunal si çdo institucion tjetër publik harton planin e punës dhe miraton planin e punës dhe raportin vjetor të punës , janë njëra ndër kompetencat themelore të Kuvendit Komunal , bazuar në ligjin për Vetëqeverisje Lokale , neni 40.2 .d .

Ky draft plan i punës dhe aktivitetit shërben si udhëzues për punën e Kuvendit Komunal .

Si organi me i lartë legjislativ Kuvendi i Komunës , është përgjegjës për krijimin e bazës ligjore për mes akteve normative dhe rregulloreve komunale .

Plani i punës shërben si një instrument me anë të cilit Kuvendi , mundë të mbikëqyrë punën e administratës përmes dorëzimeve të raporteve financiare dhe performances , si dhe ngrit efikasitetin e punës së Kuvendit të Komunës dhe të administratës , por njëkohësisht ngrit edhe transparencën e Kuvendit Komunal .

Identifikimi i të gjitha veprimeve që duhet të përmbushen ne planin e punës e punës gjatë vitit 2021 janë :

- Dorëzimi i raporteve financiare çdo tre muaj

- Dokumente që kanë për t'u shqyrtuar nga Kuvendi si dhe lista e rregulloreve të nevojshme dhe të kërkuara me ligj .
- Aktivitetet e procesimit të buxhetit :dëgjimet buxhetore , korniza afatmesëm buxhetore , miratimi i buxhetit dhe takimet me qytetarë
- Miratimi dhe rishikimi i rregulloreve komunale , rregulloret komunale te cilat mundte te rishikohen sipas nevojave .

- Strategjia për Komunikim dhe marrëdhënie me Publikun
- Plani Lokal për Integritet;
- Rregullorja komunale për të drejtat e fëmijëve;
- Strategjia kundër dhunës në familje;
- Plani trevjeçar për strehim social;
- Plani për Trashëgimi Kulturore;
- Strategjia për zhvillim Ekonomik Lokal;
- Plan Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural;
- Plani për Energji Efiçiente;
- Plani për Menaxhimin e tokave rurale;

- Aktivitetet e Komiteteve të Kuvendit
- Aktivitetet e grupit jo formal të garave (vizita , takime me qytetarë , plani i veprimit) etj.
- Aktivitetet e Kuvendit Komunal (takime me qytetarë , vizita , aktivitete ceremoniale) etj.

Aktivitetet të cilat janë paraparë për çdo muaj (Janar –Dhjetor 2021 ,që mundë të kenë edhe plotësim tjera , sipas nevojës dhe funksionalitetit më të mirë të Kuvendit , janë dhënë më poshtë të ndara për çdo muaj . (por që do të mundë edhe të ndryshon në data për arsye objektive në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës)

Mbledhjet e rregullata te Kuvendit te Komunes do të mbahen sipas periodës kohore sipas tabelës në vijim .

Janar		Tjera
Mbledhja e KPF-se 27 Janar 2021 Mbledhja e Kuvendit 29 Janar 2021		

Shkurt Mbledhja e KPF-së 24.02.2021 Mbledhja e Kuvendit 26.02.2021	Plani i punës së Kuvendit Komunal Bartja (Rialokimi) i buxhetit nga viti 2019 në 2020 Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave	
Mars Mbledhja e KPF-së Mbledhja e Kuvendit	Raporti vjetor financiar i Komunës për vitin 2020 Raport mbi gjendjen e sigurisë në Obiliq Informate mbi listën e pronave komunale Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave	
Prill Mbledhja e KPF-së Mbledhja e Kuvendit	Shqyrtimi i raportit financiar :Janar –Mars Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave	Vizit zyrtare e KK
Maj Mbledhja e KPF-së Mbledhja e Kuvendit	Qarkorja e parë buxhetore MF-se Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave	
Qershor Mbledhja e KPF-së Mbledhja e Kuvendit	Miratimi i KAB 2022-2024 Rishikim i buxhetit për vitin 2021 Rishikimi I plantit të zyrës së prokurimit Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave	
Korrik Mbledhja e KPF-së Mbledhja e Kuvendit	Raport financiar Mars –Qershor Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 Raport i DKA-së për përfundimin e vitit Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave	
Gusht Mbledhja e KPF-së Mbledhja e Kuvendit	Qarkorja e dytë buxhetore Raport i DBZHR – mbi korrje –fshirje Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave	

Shtator Mbledhja e KPF-së Mbledhja e Kuvendit	Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit komunal për vitin 2022 Raport mbi fillimin e vitit të ri shkollor Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave	Vizit zyrtare
Tetor Mbledhja e KPF-së Mbledhja e Kuvendit	Raport financiar Korrik- Shtator Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave	
Nëntor Mbledhja e KPF-së Mbledhja e Kuvendit	Raport nga DSHMS-ja për ofrim të shërbimeve Raport nga DIL- mbi projektet Raport nga DKRS-së mbi gjendjen sportive Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave	
Dhjetor Mbledhja e KPF-së Mbledhja e Kuvendit	Raporti vjetor i KKSB-së Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave	

Me rekomandim te komisionit mbledhjet e Kuvendit Komunal të mbahen çdo herë në javën e tret të çdo muaji.

Pas aprovimit të planit të punës së Kuvendit , së bashku me ekzekutivin do të bëjmë planin e veprimit për vitin 2021 .

Me respekt!
